



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark"
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 85 Prot.

Tiranë 30/03/2017

Lënda: Mbi përcjelljen e listave të kandidatëve aplikues për institucionet e rivlerësimit kalimtar.

Drejtuar: Kryetares së Bordit Drejtues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
Zj. Genoveva Ruiz CALAVERA

Tiranë

E nderuara zj. Calavera,

Në zbatim të nenit 5, ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.18/2017, "Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit", institucioni i Avokatit të Popullit pas shqyrtimit të kujdesshëm të dokumentacionit plotësues të paraqitur nga kandidatët aplikantë që kanë shprehur interes për të qënë pjesë e institucioneve të rivlerësimit kalimtar, ka rishikuar listën me kandidatët që plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion, si dhe listën me kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriteret formale.

Sikurse jeni vënë në dijeni, ky proces verifikimi u realizua nën monitorimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të ofruar nga ekspertët e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të cilët ofruan të gjithë ekspertizën e nevojshme për realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij procesi.

Në përputhje me nenin 7, pika 6, të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", po Ju përcjellim të gjitha dosjet individuale të kandidatëve si dhe listat përmbledhëse, nga të cilat rezulton se:

1. Plotësojnë kriteret formale 84 (tetëdhjetë e katër) kandidatë.
2. Nuk plotësojnë kriteret formale 109 (njëqind e nëntë) kandidatë.

Duke ju falenderuar për mbështetjen e vazhdueshme si dhe për kontributin e vyer të shkëlqesisë Suaj në krye të misionit ndërkombëtar, që po monitoron këtë proces të rëndësishëm dhe jetik për vendin, në mënyrë të veçantë duke shprehur mirënjohjen time personale dhe të institucionit të Avokatit të Popullit, për punën, profesionalizmin dhe korrektësinë e ekspertëve tuaj shprehim gadishmërinë që të japim çdo sqarim të mëtejshëm dhe informacion në lidhje me këtë proces.

Ju lutem pranoni konsideratën time më të lartë,

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

